



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr.122 /2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me numër 03/L-040, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal me Nr.03/L-49, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kërkesën e Kryetarit të Familjeve të Dëshmorëve në Han të Elezit me numër 02/Nr.455/2011 të datës 07.10.2011, Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës 02/Nr.455/2011, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2011 merr këtë:

V E N D I M

P Ë R

LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR DËRGIM NË BANJË FAMILJET E DËSHMORËVE

I

Me këtë vendim miratohet propozim vendimi me numër 01/Nr.122/2011 i datës 21/10/2011 për ndarjen e mjeteve financiare për dërgimin në banjë familjet e dëshmorëve.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të Komunës. Mjetet financiare që ndahen për këtë qëllim janë në vlerë prej 2000 €, nga 200 € për një anëtarë për trajtim 10 ditore për 13 familje të dëshmorëve. Mjetet financiare do të merren nga kategoria buxhetore mallra dhe shërbime.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve në Han të Elezit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.10.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

